



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 37, datë 09. 10. 2012

**PËR
“VENDOSJEN E “SHTATORES SË HASAN PRISHTINËS”**

Mbështetur në nenin 8/VII, gërma “a” dhe nenin 32, gërma “m” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), si dhe të kërkesës nr. prot. 5650, datë 18.07.2012 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen në kuadrin e festimeve të 100 Vjetorit të Pavarësisë, të “Shtatores së Hasan Prishtinës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë vendosjen e “Shtatores së Hasan Prishtinës” në krah të Muzeut Historik Kombëtar, me pamje nga bulevardi “Zogu I”, të pasqyruar në planvendosjen, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI**